



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË LIBOHOVË

Nr. 114 Prot

Libohovë më 21.01 .2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, Datë .01.2026

PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT PËR VLERËSIMIN DHE PARASHIKIMIN AFATMESËM
TË TË ARDHURAVE TË BASHKISË LIBOHOVË PËR VITET 2027 - 2029

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe të Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Këshilli i Bashkisë Libohovë, në mbledhjen e datës 26.01.2026, pasi mori në analizë raportin e përgatitur nga Grupi për Menaxhimin Strategjik,

VENDOSI:

- I. Të miratojë Raportin për vlerësimin dhe parashikimin afatmesëm të të ardhurave të Bashkisë Libohovë për vitet 2027-2029 sipas dokumentit bashkëlidhur.
- II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi për Menaxhimin Strategjik pranë Bashkisë Libohovë.

JURISTI

Kristaq Ciko

PËRGJEGJËS SEK.FINANCIAR

Marsela Zharkalli



RELACION

PËR VLERËSIMIN DHE PARASHIKIMIN AFATMESEM TË TË ARDHURAVE

2027-2029

1. Legjislacioni mbi te cilin eshte mbeshtetur hartimi i parashikimit afatmesem te te ardhurave per vitet 2027-2029.

Misioni i buxhetit afatmesem, ashtu si gjithe buxhetet e hartuara edhe me pare nga Bashkia Libohove, eshte te jete gjithperfshires, i pranishem, perceptues, transparent, por mbi te gjitha te jete i ligjshem dhe ne dobi te komunitetit.

Ne kete kuader, hartimi i parashikimit afatmesem te te ardhurave eshte pergatitur ne mbeshtetje te:

- a. Ligji nr.139/2015 "Per Veteqeverisjen Vendore:
- b. Ligji nr.68/2017 "Per Finanacat e veteqeverisjes Vendore"
- c. Ligji nr.9936 date 20.06.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise ", te ndryshuar
- d. Udhezimi nr.23 date 30.07.2018 "Per procedurat standarte te pergatitjes se PBA te njesive te veteqeverisjes vendore.

Raporti per vleresimin dhe parashikimin afatmesem te te ardhurave eshte mbeshtetur ne nenin 34 te Ligjit nr.68/2017 "Per finanacat e veteqeverisjes vendore", ku jepen te dhena per:

- Te ardhura per dy vitet para vitit buxhetor
- Te ardhurat e vitit buxhetor
- Parashikimin e te ardhurave per tre vitet e ardheshme buxhetore

II. Metodologjia e perdorur per parashikimin afatmesem te te ardhurave

Te ardhurat e veta perfshijne te gjitha burimet e te ardhurave me perjashtim te transfertes nga burimet qendrore. Keto burime te ardhurash perdoren per financimin e funksioneve te percaktuara ne Ligjin nr.139/2015 "Per veteqeverisjen vendore"

Procesi i planifikimit te te ardhurave te veta u realizua ne bashkepunim me administraten e institucionit dhe ne mbeshtetje te Vendimeve te Keshillit. Parashikimi eshte mbeshtetur kryesisht ne llogaritjen e kapacitetit te tarifave , informacion I perfituar nga sektori I tatim-taksave qe realizon te ardhurat, sektori I bujqesise, sektori I urbanistikes , si dhe ne politikat e percaktuara per periudhen ne vazhdim, duke u mbeshtetur ne aktet ligjore per to.

Po ashtu keto parashikime mbeshteten ne perlogaritje te pergjithshme, qe jane te lidhura ngushte me masat qe priten te ndermerren nga administrata per realizimin e parashikimeve te pretenduara te te ardhurave.

Te ardhurat nga burimet e veta vendore per Bashkine Libohove perfshijne te ardhurat nga tarifat vendore, te ardhura nga taksat lokale dhe te ardhura te tjera nga taksat e ndara (grandet).

**PARASHIKIMI TE ARDHURAVE
PER VITET 2024-2029**

	Emertimi i burimeve financiare	2024	2025	2026	2027	2028	2029	SHUMA
1	Te ardhura nga burimet e veta	4,373,900	4,463,000	4,863,000	4,527,700	4,542,800	4,557,800	27,328,200
2	Taksë e nd/ inf,nder e reja	800,000	400,000	400,000	600,000	800,000	1,000,000	4,000,000
3	Tarifa vendore	3,429,300	8,373,100	9,612,100	9,040,000	10,911,000	11,271,000	52,636,500
4	Te ardhura nga asetet	2,022,600	830,000	797,200	900,000	900,000	900,000	6,349,800
5	Te tjera administrative	2,231,000						2,231,000
	TOTALI	12,856,800	14,066,100	15,672,300	15,067,700	17,153,800	17,728,800	92,545,500

Planifikimi i te ardhurave te veta pritet te ndryshoje ne vitet ne vazhdim ne vartesi te taksave dhe tarifave vendore qe do te miratohen ne Paketën Fiskale

GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK

Leonard Hidi

Arjola Dhjamandi

Xhelil Tusuni

Kristaq Ciko

Marsela Zharkalli

Nelson Sejdo

Xhevahir Sinani

Eduart Zejneli

Arjan Çano



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBOHOVË
SEKTORI I SHËRBIMEVE BUJQËSORE, VETERINARE DHE MJEDISORE

Nr. 95 Prot

Libohovë, më 20.01.2026

Lënda: Relacion mbi demet e shkaktuara nga rreshjet ne sektorin e bujqesise në Bashkinë Libohovë.

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Libohovë

Në bashkinë Libohovë rreshjet e diteve te fundit kane shkaktuar permbytje ne zonen e fshatit Bulo ne nje siperfaqe prej 30 ha ku 20 ha ka qene e mbjelle e kultura bujqesore dhe 10 ha ka qene e pa mbjelle(djer) gjithashte ne zonen e Amites ka patur vatra te permbytura ne siperfaqe te kufizuara ku prania e ujit ka qendruar per rreth 24 ore. Permbytje ka patur ne argjinaturen e fushes se Stojanit ne siperfaqe prej 2-3ha. Gjithashtu rreshjet penguan vjeljen e kultures se misritecila perfundojti me vonese dhe me kosto te larte per shkak te lageshtires se larte. Ne zonen malore pate vershime te prenjve malore te cilet sollen aluvione mbeturina,gure dhe drure duke shkaktuar bllokime tombinosh dhe gryerje ne shpatet e tyre Shkalla e erozionit ka qene e larte mbi normen e erozionit natyral. Pritat malore ne te gjithe prenjte jane te mbushura . Nuk ka demtime ne digat e liqeneve si dhe ne shkarkuesit e tyre . lumi I suhes ishte afer kufirit maksimal por mbi uren e Zonjes ka tendence gryerje per nga fusha e stojanit ndersa diga ne uren e Zonjes funksionjti normalisht duke mbrojtur Fushen e suhes nga vershimi I lumit.Ka dy raste ne demtimin e bazes ushqimore(dengje) si dhe dy raste ne demtimin e prodhimit te misrit ne magazine per shkak te hyrjes se ujit Gjithashtu nga situata e kohes se keqe eshte kostatuar demtimi I nje stalle qe mbareshton te imta si dhe demtimi I 3 krereve te imta (dhi) demtime ka dhe ne rrjetin e rrugeve bujqesore. Ne fondin pyjor ka renie pemesh po rastet jane te izoluara po keshtu ka rreshqitje dherash ne pjese te vecanta . Ne kulturat dru-frutore nuk jane kostatuar deme por jane penguar kryerja e punimeve ne siperfaqet e mbjella me keto kultura

Specialist Bujqesore
Filip Zeq
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPERISË

BASHKIA LIBOHOVË

Nr. 97 Prot

Libohovë më 20.01.2026

Relacion për Këshillin Bashkiak

Lënda: Relacion mbi situatën e krijuar nga reshjet e dendura në territorin e Bashkisë Libohovë

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Bashkisë Libohovë,

Në vijim të situatës së krijuar si pasojë e reshjeve të dendura të rëna gjatë këtij muaji, ju paraqesim relacionin mbi dëmet e shkaktuara në territorin e Bashkisë Libohovë dhe masat e ndërmarra deri në këto momente.

Si pasojë e reshjeve intensive, në territorin e Bashkisë Libohovë janë shkaktuar dëme të konsiderueshme nga vërshimi i ujërave dhe rrëshqitjet e dherave. Një nga dëmtimet kryesore ka qenë ura në segmentin rrugor **Suhe – Gryka e Selckës**, e cila u dëmtua nga vërshimi i ujërave. Bashkia ka ndërhyrë menjëherë dhe ka realizuar riparimin e urës së dëmtuar, duke rikthyer lëvizshmërinë në këtë aks rrugor.

Gjithashtu, janë evidentuar dëmtime të argjinaturës në proin e lagjes **Baillo**, në një gjatësi rreth 50 metra linearë. Për këtë dëmtim, si dhe për rastin e urës së sipërpërmendur, jemi në komunikim të vazhdueshëm me **Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC)** dhe i kemi raportuar të gjitha të dhënat sipas kërkesave të tyre.

Zona më e prekur dhe me dëmet më të konsiderueshme është **Njësia Administrative Zagori**. Në këtë zonë janë evidentuar probleme të shumta, kryesisht rrëshqitje dherash, dëmtime të rrugëve dhe dëmtime të banesave.

Dëme të konsiderueshme janë shënuar në fshatrat **Zhej** dhe **Lliar**, të cilat aktualisht janë të izoluara si pasojë e prishjes së rrugës që lidh këto fshatra. Rruga është dëmtuar rëndë nga rrëshqitjet e dherave dhe të skarpateve të malit. Aktualisht, Bashkia është në komunikim të vazhdueshëm me AKMC-në dhe Prefekturën, dhe po pritet ndërhyrja e Forcave të Armatosura me mjete të rënda për hapjen e rrugës.

Në fshatin **Topovë** është konstatuar një bllokim i pjesshëm i rrugës hyrëse, si pasojë e rrëshqitjes së dherave anësore. Po ashtu, rrëshqitje ka pasur edhe në fshatin **Hoshtevë**, por aktualisht rruga është e kalueshme dhe nuk paraqet probleme serioze për qarkullimin.

Në Njësinë Administrative Zagori janë evidentuar edhe dëmtime në banesa. Konkreisht:

- Në fshatin **Zhej**, rrëshqitja e terrenit ka shkaktuar dëmtimin e një banese, e cila ka pësuar dëme të konsiderueshme dhe shembje të fasadës lindore. Banesa është aktualisht e pabanueshme. Gjithashtu, rruga e fshatit është bllokuar nga rrëshqitjet e dherave si pasojë e shkëputjes dhe erozionit të tokës.
- Në fshatin **Hoshtevë**, janë dëmtuar dy banesa të banuara si pasojë e rrëshqitjes së dherave. Këto banesa kanë pësuar dëmtime në strukturë dhe janë shpallur të pabanueshme.
- Në fshatin **Konckë**, janë dëmtuar dy objekte banimi si pasojë e rrëshqitjes së tokës dhe erozionit. Të dy objektet janë të pabanuara.

Bashkia Libohovë vijon të ndjekë nga afër situatën, është në komunikim të vazhdueshëm me institucionet përgjegjëse dhe po ndërmerret të gjitha masat e mundshme për menaxhimin e emergjencës dhe garantimin e sigurisë së banorëve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË LIBOHOVË

Nr. 131 Prot

Libohovë më 23/01.2026

PROJEKT-VENDIM

NR _____, DATË 23.01.2026

PËR

NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 79, DATË 20.12.2024 TË KËSHILLIT TË BASHKISË LIBOHOVË “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË LIBOHOVË PËR VITIN 2025”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të Ligjit nr. 84/2022 “Për Buxhetin e vitit 2023”, të UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, si dhe bazuar ligjit nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, Aneksit 9 “Granti i Performancës për Bashkitë” Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të shtetit per Pushtetin Vendor nr. 10315 dhe nr. 10725, datë 11.07.2025; Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve në kuadër të Grantit të Bazuar në Performancë 2025; shkresës së Ministrisë së Financave – Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, datë 24.12.2025; Këshilli i Bashkisë Libohove, në mbledhjen e datës 26.01.2026 me propozim të Kryetarit,

VENDOSI:

Të miratojë detajimin e fondit të Grantit të Bazuar në Performancë (GBP) për vitin 2025 për Bashkinë Libohovë, në vlerën totale 2,813,957.43 lekë, nga të cilat:

1,258,426.97 lekë nga burimi i brendshëm;

1,555,530.46 lekë nga burimi i huaj.

➤ **SHTOHEN TË ARDHURAT:**

Gr 00, Kap.01 Tit. 04960 , Artik. 604 “Transfertë e pakushtezuar sektoriale “në vlerën totale 2,813,957.43 lekë,

➤ **SHTOHEN SHPENZIMET**

- **Gr. 00, Kap. 01, Tit. 04520, Artik. 231, në vleren 2,813,958.43 lekë.**

- I. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjithë sektorët pranë Bashkisë
- II. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

JURIST

KRISTAQ CIKO



SHEF.SEK.FINANCIAR

MARSELA ZHARKALLI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

RELACION

PËR

NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.79 , DATË 20.12.2024 TË KËSHILLIT TË BASHKISË LIBOHOVË “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË LIBOHOVË PËR VITIN 2025”

Të nderuar këshilltarë,

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të Ligjit nr. 84/2022 “Për Buxhetin e vitit 2023”, të UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, si dhe bazuar ligjit nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, Aneksit 9 “Granti i Performancës për Bashkitë” Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor nr. 10315 dhe nr. 10725, datë 11.07.2025; Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve në kuadër të Grantit të Bazuar në Performancë 2025; shkresës së Ministrisë së Financave – Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, datë 24.12.2025; Këshilli i Bashkisë Libohovë, në mbledhjen e datës 26.01.2026 me propozim të Kryetarit,

Sipas tabelës zyrtare të detajimit të Grantit të Bazuar në Performancë për vitin 2025, Bashkisë Libohovë i është akorduar fondi **Transferte e pakushtezuar sektoriale është në vlerën totale 2,813,957.43 lekë** me burim financimi Buxheti i Shtetit, nga te cilat:

1,258,426.97 lekë nga burimi i brendshëm;

1,555,530.46 lekë nga burimi i huaj.

Përdorimi i fondit të Grantit të Bazuar në Performancë synon të mbështesë Bashkinë Libohovë në përmbushjen e objektivave të saj për blerjen e një autobetoniereje me vetengarkim. Kjo makineri është thelbësore për prodhimin e betonit dhe do të shërbejë për nevojat e shumta të Bashkisë në realizimin e projekteve të ndryshme infrastrukturore, duke qene se Bashkia Libohovë ndodhet para rrethanave të tilla të cilat e bëjnë të nevojshme dhe emergjente pasjen e një mjeti të tillë. Në pamundësi për të pasur të gjithë dokumentacionin përkatës që nevojitet për të paraqitur në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të datës 26.01.2026, po Ju kërkohet paraprakisht sa u tha më lart, për të mos ngadalësuar ecurinë dhe mbarëvajtjen e punës.

Duke shpresuar të meret në konsideratë kjo kërkesë,

Me konsideratë,

Shef. Sektorit Financiar

Marsela Zharkalli

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Marsela Zharkalli', written in a cursive style.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBOHOVË
SEKTORI I KULTURËS ARSIMIT DHE MIRËQËNIES SOCIALE

Nr. 40 Prot

Libohovë, më 14.01 .2026

Lënda: Materiale për mbledhjen e këshillit bashkiak.

SEKRETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË
LIBOHOVË.

Bazuar shkresës tuaj me nr prot .63, datë 14.01.2026 ju bëjmë me dije se në mbledhjen e rradhës, Zyra e shërbimit social, do të paraqesi relacionin dhe projekt-vendimet e poshtëshënuara.

1.Projekt –vendim, për dhënien e ndihmës, nga fondi 6%, për muajin dhjetor 2025.

2.Relacion dhe projekt –vendim, për miratimin e kritereve për përfitimin e ndihmës ekonomike nga fondi 6% dhe fondi I vet bashkisë.

Bashkëngjitur do të gjeni materialet që do paraqiten në mbledhjen e K.B.

Ju faleminderit për bashkëpunimin.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBOHOVË

SEKTORI I KULTURËS, ARSIMIT DHE MIRËQËNIES SOCIALE

Nr. Prot

Libohovë më 14.01.2026

PROJEKT- VENDIM

Për përcaktimin e kritereve, për përfitimin e ndihmës ekonomike, nga fondi I bashkisë dhe fondi 6% .

KËSHILLIT TË BASHKISË LIBOHOVË.

Bazuar në Vendimi Nr.597 ,datë 4.9.2019 Për “Përcaktimin e procedurave ,të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, në pikë3 të paragrafit IV në vendimin Nr.597 ,datë 4.9.2019 bashkia mund të shtoj ose jo fonde nga buxheti vendor,I cili i shtohet fondit të kushtëzuar, në pikë1 të paragrafit IV në vendimin Nr.597 ,datë 4.9.2019 , përdorimi i fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike ,K.B.miraton në fillim të vitit kriteret për dhënie e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese për ndihmë ekonomike të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi I pikëzimit dhe që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike.

Kriteret e përcaktura për familjet në nevojë dhe që do të trajtohen nga fondi 6% dhe nga fondet e akorduara nga Bashkia Libohovë.

- 1.Familje në nevojë me një prind ,me të paktën një fëmijë qe ndjek arsimin bazë .
- 2.Viktimat, e dhunës në marrëdhëniet familjare ,për periudhën pas vlefshmërisë të urdhërit të mbrojtjes .
3. Persona ,të vetmuar ,në moshë para pensionit, të cilët nuk kanë të ardhura të tjera.
- 4.Persona, të cilët përfitojnë paaftësi, të vetëm ,që nuk kanë të ardhura të tjera.
- 5.Familje në nevojë të cilët kanë fëmijë që ndjekin shkollat e spacializuara(kompesim transporti).
- 6.Familje në nevojë me fëmijë të mitur ,me raste urgjente(fatkeqesi të ndryshme).

Ju faleminderit .

Spektori Shërbimit Social
Majlinda Gjika



Juristi
Kristaq Ciko



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBOHOVË
SEKTORI I KULTURËS, ARSIMIT DHE MIRËQËNIES SOCIALE

Nr. Prot

Libohovë më 14.01.2026

RELACIO

Për përcaktimin e kriterëve, për përfitimin e ndihmës ekonomike, nga fondi I bashkisë dhe fondi 6% .

KËSHILLIT TË BASHKISË LIBOHOVË.

Në 1 Janar 2018 ka hyrë në fuqi sistemi i ri i ndihmës ekonomike ,i cili bazohet në vetëdeklarimin që anetarët madhorë të familjeve në nevojë deklarojnë pranë njësive të tyre vendor .

Si rrjedhojë e këtij procesi jo të gjithë aplikantët dalin fitues nga sistemi I ndihmës ekonomike. Nje pjesë e aplikantëve jo fitues nga sistemi ,kanë të drejtë të përfitojnë nga fondi i kushtëzuar 6%, bazuar në ,ligjin nr.57/2019 “Për asistencë sociale në Republikën e Shqipërisë”neni 21.Roli I Këshillit Bashkiak,ku citohe:Këshilli bashkiak miraton kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, bazuar në vlerësimin social-ekonomik të kryer nga administratori shoqëror. Familjet në nevojë trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, duke përfshirë ose jo edhe fonde të buxhetit vendor.Përdorimi i fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave

Vendimi Nr.597 ,datë 4.9.2019 Për “Përcaktimin e procedurave ,të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike “

Bazuar në pikë1 të paragrafit IV në vendimin Nr.597 ,datë 4.9.2019 , përdorimi i fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike ,K.B.miraton në fillim të vitit kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese për ndihmë ekonomike të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi I pikëzimit dhe që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike.

Bazuar në pikë3 të paragrafit IV në vendimin Nr.597 ,datë 4.9.2019 bashkia mund të shtoj ose jo fonde nga buxheti vendor,I cili i shtohet fondit të kushtëzuar.

Nga fondet e vet bashkise të përfitojnë ndihmë personat të cilët dalin jo fitues nga skema e ndihmës dhe personat ne nevoje të cilët nuk mund të aplikojnë për arsye të ndryshme.

Bashkia Libohovë në buxhetin e vitit 2026 ka akorduar, nga fondet e buxhetit vendor, për Ndihmën Ekonomike fondin prej 1.500.000 lekë I cili I shtohet fondit 6% për të maksimizuar numrin e familjeve përfituese të cilat dalin jo fituese nga sistemi I pikëzimit .

Familjet do përzgjidhen ne bazë të kriterëve të miratuara nga Këshilli Bashkiak dhe masa e pagesës do të llogaritet në bazë të vendimit të keshillit.

Spektori Shërbimit Social
Majlinda Gjika

KRYETARI
Leonard HIDE



Juristi
Kristaq Oiko



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBOHOVË

SEKTORI I KULTURËS, ARSIMIT DHE MIRËQËNIES SOCIALE

Nr. Prot

Libohovë më 14.01.2026

PROJEKT- VENDIM

Për përcaktimin e kriterëve, për përfitimin e ndihmës ekonomike, nga fondi I bashkisë dhe fondi 6% .

KËSHILLIT TË BASHKISË LIBOHOVË.

Bazuar në Vendimi Nr.597 ,datë 4.9.2019 Për “Përcaktimin e procedurave ,të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, në pikë3 të paragrafit IV në vendimin Nr.597 ,datë 4.9.2019 bashkia mund të shtoj ose jo fonde nga buxheti vendor,I cili i shtohet fondit të kushtëzuar, në pikë1 të paragrafit IV në vendimin Nr.597 ,datë 4.9.2019 , përdorimi i fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike ,K.B.miraton në fillim të vitit kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese për ndihmë ekonomike të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi I pikëzimit dhe që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike.

Kriteret e përcaktuara për familjet në nevojë dhe që do të trajtohen nga fondi 6% dhe nga fondet e akorduara nga Bashkia Libohovë.

- 1.Familje në nevojë, me një prind ,me të paktën një fëmijë qe ndjek arsimin bazë .
- 2.Viktimat, e dhunës në marrëdhëniet familjare ,për periudhën pas vlefshmërisë, të urdhërit të mbrojtjes .
3. Persona ,të vetmuar ,në moshë para pensionit, të cilët nuk kanë të ardhura të tjera.
- 4.Persona, të cilët përfitojnë paaftësi, të vetmuar dhe ne gjendje te keqe ekonomike,që nuk kanë të ardhura të tjera
- 5.Familje në nevojë të cilët kanë fëmijë me aftësi ndryshe dhe që nuk përfitojnë pagesë paftësie,të cilët marrin shërbim në qendrat e spacializuara (kompesim transporti).
- 6.Familje në nevojë ,me fëmijë të mitur ,me raste urgjente(fatkeqesi të ndryshme).

Ju faleminderit .

Spektori Shërbimit Social
Majlinda Gjika



Juristi
Kristaq Ciko



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBOHOVË
SEKTORI I KULTURËS ARSIMIT DHE MIRËQËNIES SOCIALE

Nr. Prot

Libohovë ,më 14.01.2025

PROJEKT- VENDIM

Nr 1 datë, 14/01/2025

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI 6% PËR FAMILJET JO FITUESE NGA SKEMA E NDIHMËS EKONOMIKE.

Bazuar në vendimin nr. 955, datë 07.12.2016” Për përcaktimin e kritereve , të procedurave, dokumentacionit dhe masës së ndihmës ekonomike” , në udhëzimin nr.5,datë 17.02.2017.”Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind”, në udhëzimin nr 4 datë 17.02.2017 “ Për përlogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike” Ligjin 57/2019”Për asistencën sociale në RSH”,VKB Libohovë, nr.3datë 24.01.2025 “Për përcaktimin e kritereve për familjet në nevojë” ,mbështetur në vlerësimin ekonomik –social, propozojmë Këshillit Bashkiak ,për muajin DHJETOR 2025, familjet që do të përfitojnë nga fondi i kushtëzuar 6%.

Nr	Emri Atesia Mbiemri	Muaji	Shuma/lek
1	Ferdi Sejfulla Ruli	DHJETOR 2025	2178

Për zbatim të këtij vendimi ngarkohet Zyra e Ndihtmes Ekonomike.
Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

Spektori Shërbimit Social
Majlinda Gjika



Juristi
Kristaq Ciko



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. _____ prot.

Libohovë, datë . . . 2026

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____ datë ____ . ____ . 2026

PËR

“MIRATIMIN E RREGULLORES SË BRENDSHME TË SHËRBIMIT PËR ASISTENCËN SHTËPIAKE NË KUADËR TË PROJEKTIT “NJË VATËR E NGROHTË PËRTEJ SFIDAVE TË MOSHËS DHE PAMUNDËSISË”.

Këshilli Bashkiak i Libohovës, në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ . 2026, pasi mori në shqyrtim propozimin e Kryetarit të Bashkisë dhe Relacionin shoqërues të Sektorit të Shërbimeve Sociale; Bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Në ligjin nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; Udhëzimit nr.581, datë 18.12.2017 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, asistencës shtëpiake, për të moshuarit”; Stategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale dhe Planit të Veprimit në zbatim:

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rregullore së Brendshme të Shërbimit për Asistencën Shtëpiake për projektin “Një vatër e ngrohtë përtej sfidave të moshës dhe pamundësisë”, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Miratimin e strukturës (organogramës) së personelit që do të angazhohet për këtë shërbim, i përbërë nga specialistët përkatës.
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Sektori i Shërbimeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi, duke siguruar mjetet e nevojshme logjistike për njësinë lëvizëse.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

JURIST
Kristaq Ciko

NËNKRYETAR
Arjola Dhjamandi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBOHOVË
SEKTORI I KULTURËS, ARSIMIT DHE MIRËQËNIES SOCIAL

Nr. 88 prot.

Libohovë, datë 19.01 .2026

RELACION

Lënda: Mbi miratimin e Rregullores së Brendshme të Shërbimit për Asistencën Shtëpiake në kuadër të projektit “Një vatër e ngrohtë përtej sfidave të moshës dhe pamundësisë”.

Drejtuar: KRYETARIT TË BASHKISË,

LIBOHOVË

Ky relacion shoqëron Rregulloren e shërbimit të asistencës shtëpiake, i cili synon t’u përgjigjet nevojave të të moshuarve dhe personat me Aftësi të Kufizuar(PAK) në Bashkinë Libohovë. Projekti ka si mision ofrimin e kujdesit në ambjentin natyral të përfituesit, duke siguruar mirëqënien shoqërore, shëndetësore dhe dinjitetin e tyre.

1- **Baza Ligjore;** Rregullorja është hartuar në ërputhe të plotë me:

Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë(neni 102, pika 4).

Ligjin nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”.

Udhëzimin nr.581, datë 18.12.2017 “Për standardet e shërbimeve të asistencës shtëpiake”.

Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale.

2- **Përmbledhje e Shërbimeve të Ofruara;** Shërbimi do të ofrohet nga një njësi lëvizëse dhe do të përfshijë:

Kujdes shëndetësor- Asistencë e infermierit, furnizim me barna dhe shoqërim për vizita mjekësore.

Mbështetje sociale- Hartimi i planeve individuale të kujdesit, këshillim psikologjik dhe fizioterapi.

Asistencë në banesë- Higjenë personale, furnizim me ushqime dhe ndihmë për aktivitete të përditshme.

3- **Grupi i synuar (target grupi);**

Përfitues janë të moshuarit dhe PAK që jetojnë të vetmuar, nuk kanë asistencë nga familjarët dhe nuk trajtohen me shërbime të tjera. Identifikimi do të bëhet nga punonjësi social përmes kërkesave direkte apo sinjalizimeve nga komuniteti apo profesionistë të tjerë territor.

4- **Burimet Njerëzore;** Për realizimin e projektit stafi përbëhet nga 8 specialistë:

1 punonjës social,
1 infermier,
3 kujdestare,
1 psikolog dhe 1 fizioterapist (me kontratë shërbimi)
1 shofer.

Ky shërbim plotëson një nevojë për komunitetin e Libohovës, duke parandaluar izolimin social dhe duke rritur cilësinë e jetës për shtresat më në nevojë.

Miratimi i kësaj rregulloreje siguron një proces të standardizuar, transparent dhe profesional për funksionimin e strukturës së asistencës shtëpiake gjatë vitit 2026 e në vijim.

Nënkryetari i Bashkisë
Arjola Dhjamandi

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Arjola Dhjamandi', written over a horizontal line.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
NJËSIA E PERFORMANCËS

Nr. 24 Prot.

Libohovë, më 22 . 01.2026

RELACION

PËR PARAQITJEN E RAPORTIT TE PERFORMANCËS SË BASHKISË
LIBOHOVË PËR VITIN 2024.

Në zbatim të detyrimeve ligjore për transparencën, llogaridhënien dhe monitorimin e performancës së njësisve të vetëqeverisjes vendore, si dhe në funksion të ushtrimit të kompetencave të Këshillit Bashkiak, ju paraqitet për shqyrtim Raporti i Performancës së Bashkisë Libohovë, i shoqëruar me material prezantues përmbljedhës.

Raporti pasqyron gjendjen e shërbimeve kryesore bashkiake dhe ecurinë e treguesve të performancës në sektorë si arsimi parauniversitar, infrastruktura ujitëse dhe kulluese, administrimi i pyjeve dhe kullotave, mbrojtja nga zjarri dhe menaxhimi i emergjencave, si dhe menaxhimi i mbetjeve, duke evidentuar arritjet, problematikat dhe sfidat kryesore.

Materiali prezantues , i bashkëngjitur këtij relacioni, është përgatitur për të paraqitur në mënyrë të përmbljedhur gjetjet kryesore dhe për të lehtësuar diskutimin në Këshillin Bashkiak.

Paraqitja e këtij raporti synon informimin e Këshillit Bashkiak, mbështetjen e vendimmarrjes së bazuar në të dhëna konkrete, forcimin e transparencës dhe orientimin e politikave dhe investimeve vendore.

Ju faleminderit.

Koordinator i Performancës

Armando Tusuni



REPUBLIKA E SHQIPERISË

**BASHKIA LIBOHOVË
KRYETARI**

RREGULLORE E BRENDSHME
SHËRBIMI PËR ASISTENCËN SHTËPIAKE

“PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE DETYRAT NË
PROJEKTIN “NJË VATËR E NGROHTË PËRTEJ SFIDAVE TË
MOSHËS DHE PAMUNDËSISË”

2026

Miratoi

Kryetari

Leonard Hida



Rregullore e Brendshme Shërbimi

për Asistencën Shtëpiake

Rregullorja e brendshme e shërbimit për Asistencë Shtëpiake bazohet në:

Pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3 të nenit 27 dhe 51 të ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe të Udhëzimit nr. 581, datë 18.12.2017 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, asistencë shtëpiake, për të moshuarit” si dhe ligjit nr. 121, datë 21.11.2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale, dhe Planit të Veprimit në zbatim.

Përshkrimi i shërbimit

Misioni i Asistencës Shtëpiake – Objektivi i ndërhyrjes

Projekti lëvizës “Një vatër e ngrohtë përtej sfidave të moshës dhe pamundësisë”, në Bashkinë Libohovë, nëpërmjet asistencës shtëpiake do t’i përgjigjet nevojave të të moshuarve dhe PAK(persona me aftësi të kufizuar), për përkujdesje, në ambientin e tyre natyral në kohë dhe me cilësi. Shërbimi i asistencës shtëpiake, siguron, për aq sa është e mundur, ofrimin e shërbimit pranë familjes ose komunitetit të përfituesit të shërbimit, me qëllim sigurimin e mirëqenies shoqërore.

Shërbimi në shtëpi për të moshuar dhe PAK, siguron integrimin e shërbimeve të kujdesit ditor që u ofrohet në familje , të cilët janë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët dhe përfshin: (i) Përmbyshjen e nevojave të përditshme, sipas vlerësimit, rast pas rasti; (ii) Furnizimin e barnave apo furnizime të tjera jetike; (iii) Shërbime bazë mjekësore dhe infermierie; (iv) Mbajtjen e higjienës personale; (v) Shërbime rehabilitimi, zhvillimi, këshillim sipas rastit.(vi) shoqërimin për kryerjen e vizitave mjekësore, ekzaminimin, komisjonimet etj. Shërbimi garanton dinjitetin e banorit, marrëdhëniet ndërpersonale, iniciativat dhe ndjenja e përgjegjësisë për veprime personale.

Target grupi dhe sistemi i evidentimit

Target grup për pëfitimin e shërbimit janë të moshuar dhe PAK në nevojë të cilët jetojnë të vetmuar dhe nuk kanë asnjë lloj asistence nga familjarët ose nuk përfitojnë shërbime të tjera nga struktura të qeverisjes vendore ose shërbime nga organizata të shoqërisë civile.

Të moshuarit/PAK do të evidentohen nga shërbimet sociale të pushtetit lokal dhe referimi për të marrë shërbime për të moshuarit do të vijë prej tyre.

I moshuari/PAK në nevojë, personalisht ose përmes sinjalizimeve të familjes, të njohurve, mjekut të familjes, administratorit social të zonës, profesionistëve socialë - shëndetësorë, ose të tjerë aktorëve, i drejtohet me një kërkesë për përfitim shërbimi në njësisë së vetqeverisjes vendore. Punonjësi social është personi përgjegjës për rastin. Ai rregullon qasjen e qytetarit të moshuar/PAK në rrjetin e shërbimeve sociale dhe social-shëndetësore, duke kryer vlerësimin profesional të nevojave dhe përcaktimin e rrugës për kujdes të personalizuar dhe zbatimin e tij në drejtim të përshtatshmërisë dhe efektivitetit, duke siguruar menaxhimin dhe kontrollin e shërbimeve të ofruara në lidhje me objektivat.

Objektivat e shërbimit

1. Të ofrojë shërbim në përputhje me nevojat e të moshuarve/PAK dhe plotësimin e kërkesave të programeve zhvilluese sipas standardeve të miratuara.
2. Të ofrojë siguri dhe mbështetje për të moshuarit/PAK për t'i dëgjuar dhe inkurajuar që të shprehin nevojat, dëshirat dhe ndjenjat e tyre.
3. Të nxisë mundësitë që të arrijnë potencialin e tyre të plotë.
4. Të nxisë besimin dhe pavarësinë e të moshuarve/PAK.
5. Të ofrojë mundësi që të moshuarit/PAK të bëjnë zgjedhje.
6. Të hartojë plane individuale të kujdesit për të përmbushur nevojat e tyre në përputhje me standardet e miratuara.
7. Të sigurojë një bashkëpunim eficient mes ofruesit të shërbimit me familjarët si dhe persona të tjerë.
8. Të vlerësojë dhe të marrë në konsideratë të gjitha mundësitë me qëllim që të moshuarit/PAK të zhvillojnë potencialin e të tyre të plotë.

Përfituesi i Shërbimit

Përfituesi i shërbimit të asistencës shtëpiake është i moshuari/PAK në nevojë, i cili personalisht ose përmes sinjalizimeve të familjes, të njohurve, mjekut të familjes, administratorit shoqëror të zonës, ose aktorëve të tjerë, ka kërkuar përfitimin e shërbimit pranë njësisë së vetqeverisjes vendore dhe kjo e fundit ka vlerësuar domosdoshmërinë e ofrimit të këtij shërbimi ndaj aplikuesit.

Shërbimi inkurajon përfshirjen e familjes në të gjitha aspektet e procesit të rehabilitimit, si dhe vizitat e rregullta.

Funksionet kryesore të shërbimit

Shërbimi në familje do të garantojë mbështetje të specializuar. Operatorët socialë që ofrojnë shërbimin do të garantojnë që i moshuari/PAK të jetë i mbrojtur nga keqtrajtimi, diskriminimi, lënia pas dore etj. Ofruesi i shërbimit (Bashkia Libohovë) do të përzgjedhë personel të kualifikuar dhe do të zhvillojë shprehitë dhe praktikën profesionale të tyre nëpërmjet trainimit të

vazhdueshën të tyre dhe të akredituar nga institucionet përgjegjëse. Ofrimi i shërbimit ka një numër funksionesh që janë të rëndësishme për përfituesin ndaj të cilit ofrohet kujdes.

1. Çdo i moshuar do të jetë i lidhur me një profesionist/operator social për ofrimin e shërbimit të asistencës shtëpiake, i cili do të jetë lidhja kryesore mes tij dhe njësisë. Ai do të bashkëpunojë në hartimin e programit individual të kujdesit të të moshuarit/PAK.
2. Pas vlerësimit, disa të moshuar/PAK mund të kërkojnë mbikëqyrje të drejtëpërdrejtë të veprimtarive të tyre. Ata do të asistohen në lidhje me aspekte që kanë të bëjnë me kujdesin personal.
3. Kur është e mundur, të moshuarit/PAK do të inkurajohen që të marrin pjesë në veprimtari dhe programe që nxisin shprehi, të cilat i mundësojnë ata të jenë sa më të pavarur që të jetë e mundur.

Organograma dhe rregullat e menaxhimit të brendshëm

Personeli i parashikuar për shërbimin e kujdesit në shtëpi është i përbërë nga:

- 1 Punonjës social
- 1 Infermier
- 3 Kujdestarë
- 1 Psikolog(me kontratë shërbimi)
- 1 Fizioterapist (me kontratë shërbimi)
- 1 Shofer

Çdo profesionist/operator social duhet të garantojë marrjen në ngarkim të të moshuarve me nevoja të ndryshme përkujdesi apo Persona me AK në nevojë për shërbime të cilat nuk i plotësojnë dot vetë.

Çdo operator lidh një kontratë tip me bashkinë Libohovë.

Përgjegjësitë dhe detyrat e Operatorit Social:

1. Për çdo të moshuar/PAK do të kryhen vizita në banesë sipas nevojave për shërbime.
 2. Të hartojë plane individuale të kujdesit për të përmbushur nevojat e tyre në përputhje me standardet e miratuara.
 3. Të ofrojë asistencë shtëpiake në banesë për të moshuarit në të gjithë territorin e bashkisë Libohovë në përputhje me nevojat dhe planin individual të kujdesit.
 4. Mbështetje dhe ndihmë për të moshuarit/PAK;
 5. Ndërhyrje sociale për të përfituar autonomi individuale për aktivitetet e përditshme, mbajtjen dhe ruajtjen e aftësive dhe integrimin e tyre sipas rasteve specifike;
 6. Përmbushjen e nevojave të përditshme, sipas vlerësimit, rast pas rasti;
 7. Shoqërim dhe transportim (shoqërime për komisione, ekzaminime mjekësore, shoqërim kur udhëtojnë brenda qytetit apo jashtë tij, për nevoja personale ose mjekësore) etj;
-

8. Furnizimin e barnave, ushqimeve apo furnizime të tjera jetike sipas kërkesës së të moshuarit;
9. Ndihmë për shërbimet bazë mjekësore dhe infermierisë;
10. Mbajtjen e higjenes personale (p.sh dush, ngritje dhe pushim në shtrat, etj);
11. Shërbime rehabilitimi, zhvillimi të fizioterapisë dhe këshillim psikologjik sipas rastit;
12. Të ruajë konfidencialitetin e të dhënave;
13. Të ofrojë shërbim në përputhje me nevojat e përfituesve dhe plotësimin e kërkesave të programeve zhvilluese sipas standardeve të miratuara;
14. Të ofrojë siguri dhe mbështetje për të moshuarit dhe PAK për t'i dëgjuar dhe inkurajuar që të shprehin nevojat, dëshirat dhe ndjenjat e tyre;
15. Të nxisë mundësitë që të arrijnë potencialin e tyre të plotë;
16. Të nxisë besimin dhe pavarësinë e të moshuarve dhe PAK;
17. Të sigurojë një bashkëpunim eficient mes ofruesit të shërbimit me familjarët si dhe persona të tjerë.
18. Të vlerësojë dhe të marrë në konsideratë të gjitha mundësitë me qëllim që të moshuarit dhe PAK të zhvillojnë potencialin e të tyre të plotë.
19. Operatori social do të plotësojë detyrat në bashkëpunim me Njësitë Administrative dhe shërbimofruesit lokale për vlerësim, ndjekje dhe riintegrim.
20. Raportimi mbi punën e realizuar dhe shërbimin e ofruar në banesë do të kryhet mbas çdo vizite tek të moshuarit pranë titullarit përgjegjës për të projektin.

Funksionet e shërbimit

Të moshuarit dhe PAK mbështeten dhe këshillohen për të ruajtur dhe përmirësuar aftësitë e tyre personale, funksionale dhe sociale.

Aktivitetet e përditshme:

Kujdesi dhe mbështetja ofrohet për të gjitha nevojat e tyre të përditshme që janë në vetvete forma të terapisë rehabilituese.

Kujdesi konsiston në:

- Përbushjen e nevojave të përditshme, sipas vlerësimit, rast pas rasti të nevojave personale.
 - Koordinimi me qendrat shëndetësore në territor për ndjekjen shëndetësore të tyre, konsultimi me mjekët specialistë për kryerjen e ekzaminimeve të ndryshme dhe marrjen e medikamenteve në kohë.
 - Furnizimin me medikamente, ushqime, detergjentë etj
 - Shoqërim (jashtë banesë) për blerjen e barnave apo furnizime të tjera jetike si dhe për shërbime bazë mjekësore dhe infermierie.
 - Shërbime rehabilitimi, zhvillimi, këshillimi psikologjik sipas rastit.
-

- Përfshirja në aktivitete përfshirëse dhe zbavitëse në komunitet.
- Shoqërimi në Spitalin Rajonal dhe spitalet jashtë rajonit me qëllim kryerjen e vizitave të mjekët specialistë mbi komisjonimet, shtrimet apo rehabilitimin etj.

Ofrimi i shërbimit shëndetësor në banesë përfshin: monitorimi i gjendjes shëndetësore dhe kontrolli i simptomave; matje presionit të gjakut, glicemisë, kujdesi për lekuren, higjenën, ushqyerjen etj. sipas nevojës. Persa i përket ofrimit të shërbimeve psikosociale gjatë gjithë periudhës së shërbimit, do të ofrohet nga psikolog klinik i licensuar (me kontratë shërbimi) dhe konsiston në: mbështetje emocionale për të moshuarit dhe PAK, biseda, këshillime, vendosjen e lidhjeve me familjarët, adresimi i nevojave dhe problematikave të të moshuarve dhe familjareve në burimet e komunitetit (institucione, organizata, etj).

Shërbimi i fizioterapisë do të jepet nga fizioterapist i licensuar (me kontratë shërbimi) në banesë ose në klinikë sipas nevojës dhe konsiston në trajtimin e personalizuar dhe ndihmon në reduktimin e dhimbjeve, riaftësimin pas lëndimeve etj.

Shërbimi i operatorit social në banesën do të zhvillohet gjatë një periudhe të pacaktuar deri në momentin kur të moshuarit nuk do të kenë më nevojë për shërbime ose kur gjendet një zgjidhje tjetër ose asistencë nga burime të tjera.

Aktivitetet jashtë banese.

Realizimi i këtyre aktiviteteve mund të asistohet nga operatori social (sipas nje grafiku të dakortësuar më parë midis operatorit dhe të moshuarit). Sipas nevojës, mund të shoqërohen të vizitohen miqtë, të afermit tuaj ; të marrin pjesë në aktivitete familjare si dhe aktivitete sociale të organizuara nga pushteti lokal ose organizata të tjera lokale. Gjithashtu, sipas nevojës, të moshuarit do të shoqërohen në kryerjen e pazareve, kryerjen e pagesave të energjisë elektrike, ujit, në bankë, në postë, pranë gjendjes civile, në institucione të ndryshme etj.

Planet e kujdesit individual:

Plani i Shëndetit është pjesë e planit të kujdesit dhe analizohet një herë në çdo gjashtë muaj. Ofruesi i shërbimit mban dokumentacion me shkrim për të gjitha mjekimet, trajtimet dhe ndihmën e parë që marrin të moshuarit. Asistenca për procedurat e veçanta shëndetësore ndaj të moshuarit kryhen vetëm në bashkëpunim me mjekun e familjes dhe të infermierit të zonës.

Çështjet e higjienës personale trajtohen në një mënyrë të ndjeshme dhe proaktive, që ndihmojnë të moshuarit të krijojnë dhe të zhvillojnë një imazh pozitiv për veten.

Të moshuarit dhe PAK me nevoja të veçanta shëndetësore ose me aftësi të kufizuara duhet t'u sigurohet mbështetja e duhur që të nxisë një mjedis pozitiv, pa fyerje.

Të moshuarit dhe PAK i sigurohet lidhje e ngushtë me profesionistët e shëndetit, që ofrojnë këshilla dhe udhëzime për nevoja të veçanta shëndetësore.

Të moshuarit dhe PAK duhet të ndihmohen që të kuptojnë se duhanpirja, alkooli dhe përdorimi i substancave të tjera paraqesin rreziqe të veçanta për shëndetin.

Detyrime dhe të drejta për familjarët e përfituesit të shërbimeve:

- Të gjithë familjarët do të njoftohen për shërbimin që është duke përfituar i moshuari/PAK (familjar i tyre).
- Në rastet kur është e mundur takimi me ta fizikisht do të kërkohet miratim me shkrim për shërbimin që po merr i moshuari.
- Operatori do të komunikojë me familjarët dhe t'u transmetojë atyre gjëndjen e të moshuarit si dhe planin e ndërhyrjes që do të zhvillohet për ta.

Dokumentimi dhe raportimi i shërbimit

Për cdo të moshuar përfitues shërbimi krijohet një dosje personale, e cila qëndron në Bashkinë Libohovë dhe përmban një set dokumentash të përbëra nga:

- Kontrata e shërbimit.
- Formulari i informacionit për të moshuarit që përfitojnë shërbimin;
- Deklarata e qëllimit për të moshuarit e cila përmban filozofinë, misionin, objektivat, vlerat e shërbimit dhe shërbimet që ofrohen, etj
- Raporti për vlerësimin e nevojave dhe ecurinë për të moshuarin;
- Plani i kujdesit Individual;
- Raporte javore të ofrimit të Asistencës Shtëpiake;
- Databazën me të dhënat e cdo personi që merr shërbime;
- Foto të ofrimit të shërbimit.

Zyra e projektit lëvizës ka detyrimin për të raportuar një herë në 4 muaj pranë Shërbimit Social

Shtetëror dhe pranë Ministarisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale.

Kritere të përgjithshme

- Kjo rregullore zbatohet drejtpërdrejt nga çdo punonjës.
 - Punonjësit e Projektit kryejnë vetë funksionin, detyrën ose punën e ngarkuar dhe në asnjë rast nuk lejohet t'i besohet detyra personave të tjerë.
 - Rekrutimi, transferimi, dhënia e masave disiplinore apo largimi nga detyra e punonjësve të projektit, bëhet sipas procedurave të përcaktuara respektivisht në Kodin e Punës.
-

- Veprimtaria funksionale e të gjithë punonjësve lejon dhe kërkon një shkallë përgjegjësie të lartë.
- Me porosi dhe miratim të Kryetarit të Bashkisë apo nënkryetarëve, punonjësit kanë të drejtën dhe detyrimin të marrin pjesë në trajnime, seminare dhe aktivitete të tjera kualifikuese profesionale, branda fushës së veprimtarisë.

Titullari në bashki për ndjekjen e zbatimit të projektit

Kryetari i Bashkisë është titullari që ndjek dhe mbështet zbatimin e projektit.

1. Nënkyetari që ndjek zbatimin e projektit varet direkt nga kryetari.
2. Nënkyetari që ndjek zbatimin e projektit ka këto detyra:
 - a. merr masa organizative për plotësimin e detyrave të cdo punonjësi në veçanti brenda planifikimit të detyrave të projektit;
 - b. evidenton probleme që dalin nga veprimtaria e përditshme si dhe çështjet e ndryshme që ngrihen me shkrim nga qytetarët, përcakton zgjidhjet e mundshme brenda kuadrit ligjor në fuqi.
 - c. kontrollon punën e përditshme të specialistëve në varësi, për plotësimin e detyrave që i janë ngarkuar;
 - d. organizon sistemin e administrimit të informacionit dhe të statistikave për veprimtarinë e projektit;

Të gjithë Specialistet e projektit

1. Specialistët varen direkt nga Kryetari i Bashkisë.
 2. Specialistët kanë këto detyra:
 - a. zbatojnë me përpikmëri dhe në nivel të lartë profesional të gjitha detyrat e ngarkuara nga eprori;
 - b. jep përgjigje ligjore dhe teknike për problemet specifike që mbulon, sipas detyrave që i ngarkohen brenda projektit, si dhe përgatit propozime lidhur me trajtimin e çështjeve të ndryshme me karakter profesional dhe teknik, sipas fushës që mbulon;
 - c. ndjek rastet që i janë dhënë për trajtim, duke respektuar rigorozisht afatet e përcaktuara. Përgatit materialin për secilin rast ku bëhet ndërhyrja dhe jepet shërbimi.
 - d. punon në vazhdimësi për rritjen e aftësive vetjake tekniko-profesionale dhe merr pjesë në veprimtaritë trajnuese për këtë qëllim, në funksion të plotësimin sa më të mirë të detyrës së ngarkuar, por edhe të karrierës në shërbimin civil. Duhet të njohë legjislacionin në fuqi dhe në mënyrë të veçantë, atë që lidhet me punën sipas specifikës së fushës që mbulon.
-

Disiplina formale dhe administrative

1. Orari zyrtar i punës së administratës së bashkisë është 08:00 – 16:00, çdo ditë, nga e hëna në të premte, për të gjithë punonjësit, prveç ditëve të festave zyrtare, të cilat bien ditët e javës.
2. Gjatë orarit zyrtar punonjësi është i detyruar ta shfrytëzojë me intensitet kohën e punës vetëm për qëllime pune dhe detyrat e tij funksionale. Punonjësit e projektit, pjesën më të madhe të ditës janë në terren.
3. Çdo mungesë në detyrë bëhet me leje, veç rasteve shëndetësore, për të cilat të bëhet njoftimi telefonik në zyrë, duke dorëzuar raport mjekësor ditën e parë të paraqitjes në punë.
4. Listëprezenca për çdo punonjës të projektit, përgatitet dhe depozitohet cdo fundmuaji pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe ky i fundit, ia dorëzon Drejtorisë së Financës për të kaluar pagat në përputhje me ditët, për të cilat paguhet.

Etika për punonjësit e projektit dhe Kodi i Veshjes

1. Punonjësit e projektit, duhet të ruajnë reputacionin, dinjitetin si dhe të qëndrojnë larg çdo veprimi, qëndrimi apo sjellje e cila mund të zhvlerësojë emrin e mirë të Institucionit që përfaqëson.
 2. Punonjësit e projektit, janë të detyruar t'u përmbahen normave të etikës gjatë orarit të punës.
 3. Punonjësit e projektit, duhet të ruajë konfidencialitetin që buron nga ligji në lidhje me informacionin dhe materialin që njihet dhe merr dijëni gjatë kryerjes së detyrës.
 4. Punonjësit duhet të jenë të sjellshëm në marrëdhënie dhe në komunikimin shkresor e verbal me eprorët, kolegët dhe vartësit e tyre, si dhe të respektojnë parimet e etikës sipas legjislacionit në fuqi.
 5. Veshja e nëpunësve dhe punonjësve duhet të jetë serioze dhe gjatë ofrimit të shërbimit të mbajnë përparëset me logon e bashkisë.
 6. Të gjithë punonjësit e projektit, duhet të kujdesen për higjienën personale dhe paraqitjen e jashtme.
 7. Në të gjitha ambjentet e bashkisë, është rreptësisht e ndaluar përdorimi, mbajtja e pijeve alkoolike dhe pirja e duhanit.
 8. Në takime pune jashtë zyrës, nëpunësit dhe punonjësit e saj duhet të paraqiten me veshje zyrtare.
-

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore bazë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga Kryetari i Bashkise konform nenit 64/j te ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Data e hyrjes në fuqi

Libohovë më __.__.2026





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
NJËSIA E PERFORMANCËS

Nr. Prot.

Libohovë, më 22.01.2026

Lënda : Informacion përmblledhës mbi raportin e performancës së bashkisë Libohovë për vitin 2024.

KËSHILLIT BASHKIAK LIBOHOVË

Raporti përmblledhës i Performancës së bashkisë Libohovë për vitin 2024.

1. Përmblledhje e gjetjeve kryesore

Raporti i Performancës 2024 së Bashkisë Libohovë paraqet një bashki me kapacitete të qëndrueshme institucionale duke ruajtur stabilitet të lartë dhe përmirësime të dukshme në sektorët :

Menaxhimi i mbetjeve është përmirësuar ndjeshëm me rritje të territorit të mbuluar me shërbim duke garantuar nje stabilizim dhe duke mbajtur konstant nivelin e ofrimit të shërbimit.

Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit ka shënuar përmirësime të dukshme në vitet e fundit duke pasur rritje të rrjetit kullues dhe vaditës të pastruar apo të mirëmbajtur.

Administrimi i pyjeve dhe kullotave paraqitet si një nga sektorët më të qëndrueshëm, me rritje të numrit të inspektimeve dhe monitorim të rregullt të fondit pyjor dhe kullosor .

Arsimi bazë dhe i mesëm paraqet një situatë të qëndrueshme dhe infrastrukture kryesisht të mirëmbajtur .

Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi mbulon 100% të territorit të bashkisë dhe paraqet përmirësim të vazhdueshëm në trajnimet e stafit dhe pajisjet e sigurisë duke garantuar reagim funksional ndaj emergjencave.

2. Sfidat kryesore

Bashkia Libohovë përballet me një sërë sfidash strukturore që ndikojnë drejtëpërdrejtë në performancën e shërbimeve dhe zhvillimin afatgjatë :

1. Tkurja demografike dhe emigracioni

Rënia e numrit të fëmijëve në arsimin parashkollor dhe stabilizimi në nivele të ulëta tregon plakje të popullësisë dhe largim të rinjve, duke ndikuar negativisht në tregun e punës dhe .

2. Varësi e lartë nga bujqësia tradicionale

Ekonomia vendore karakterizohet nga një varësi e theksuar ndaj bujqësisë dhe blegtorisë tradicionale, me mungesë të kapaciteteve të agropërpunimit dhe integrim të kufizuar në zinxhirët e tregut .

3. Kapacitete të kufizuara financiare dhe njerëzore

Madhësia e bashkisë dhe burimet e kufizuara financiare ndikojnë në aftësinë për investime të qëndrueshme dhe projekte zhvillimi.

3. Mundësitë dhe potencialet për zhvillim

Pavarësisht sfidave, Bashkia Libohovë ka potenciale të rëndësishme për zhvillim të qëndrueshëm:

Bujqësi dhe blegtori me potencial rritjeje, veçanërisht në sektorin e bagëtive të imta dhe bimëve medicinale duke qenë se është një nga zonat më të rëndësishme për numrin e bagëtive të imta dhe sipërfaqes bujqësore dhe mban rekord në shqipëri për shumëllojshmërinë e bimëve medicinale

Turizëm kulturor dhe natyror, i lidhur me trashëgimin historike të Libohovës, arkitekturën tradicionale dhe peisazhin natyror.

Menaxhim i qëndrueshëm i pyjeve dhe kullotave, si bazë për ekonomi rurale, punësim lokal dhe mbrojtje të mjedisit.

Zhvillim i produkteve lokale me identitet territorial, që mund të shndërrohen në marka të zonës përmes mbështetjes së agropërpunimit dhe turizmit rural.

Edukimi mjedisor dhe turizmi kulturor si elementë të integruar në planifikimin urban e bujqësor.

4. Prioritetet strategjike të Kryetarit të Bashkisë

Në kontekstin e këtij raporti, prioritetet strategjike për drejtimin e bashkisë mund të fokusohen në :

1. Forcimin e ekonomisë rurale përmes investimeve në bujqësi dhe agropërpunim.
2. Nxitjen e turizmit kulturor dhe natyror si burim alternativ të ardhurash.
3. Përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve dhe mbrojtjen e mjedisit .
4. Ruajtjen dhe zhvillimin e shërbimeve arsimore dhe sociale për të frenuar emigracionin .
5. Ritjen e kapaciteteve për planifikim dhe menaxhim projektesh .

5. Pse raporti i performancës është i dobishëm për bashkinë dhe komunitetin

Ky raport shërben si një instrument i rëndësishëm për:

Vendimmarrje të bazuar në të dhëna konkrete ;

Identifikim të qartë të prioriteteve dhe sfidave;

Përmirësim të transparencës dhe llogaridhënies;

Forcim të dialogut me komunitetin dhe aktorët lokal.

6. Mesazhi për donatorët

Bashkia Libohovë është një bashki e vogël , por me potencial të lartë rural, natyror dhe kulturor.

Mbështetja e donatorëve do të kishte ndikim të drejtëpërdrejtë në :

Zhvillimin e ekonomisë bujqësore dhe turizmit rural;

Rritjen e kapaciteteve institucionale për zhvillim të qëndrueshëm;

Investime të integruara për menaxhimin mjedisor dhe infrastrukturën rurale.

Me mbështetje dhe planifikim të integruar, Libohova mund të shndërrohet në model të zhvillimit rural të qëndrueshëm dhe të bazuar në identitetin lokal.